



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0018905/25 dt. 02.04.2025

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, paragrafi 1 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë; nenit 62, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, nenit 13, të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës Nr. 12/2013; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **premtën më dt. 04.04.2025:**

T H Ë R R E T

Mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa

Seanca e 39

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Propozim vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032

Mbledhja mbahet në Sallën e Mediave duke filluar nga ora 11:00.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Nr. Prot:	02-350/09-00/7778/28
Datë/a:	25.03.2025
Për/Za/To:	Kryesuesen e Kuvendit të Komunës znj/ Vesa Broja
Cc :	Anëtarëve të Kuvendit të Komunës
Përmes/Preko/Trogugh:	Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza
Nga/Od/From:	Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm z. Edison Tërnavë, atk. Drejtor
Tema/Subjekat/Subject:	PROPOZIM-VENDIM

Bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) dhe në nenin 17 paragrafi 1 shkronja (b), lidhur me nenin 58, shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28, datë 4 qershor 2008), neni 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe neni 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, lidhur me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.2, neni 11 dhe 16 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.30/2013), e bazuar në Udhëzimin Administrativ të MMPH Nr.24/2015, Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Udhëzimin Administrativ të MMPH Nr. 08/2017, për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, neni 13 paragrafi 1 pika 1.7, neni 18 paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 77 paragrafi 1, pika 1.10, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, datë 24.09.2020, në Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-0022696/20- 2, datë 24.04.2020, për Fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe duke i marrë për bazë dy dokumente të Ministrisë përkatëse siç janë: Vendimi i MMPHI Nr. Prot.7770-2/22, datë 23.02.2023, për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe Vendimin e MMPHI Nr.prot. 3949-2/24, datë 13.11.2024, për Dhënien e Pëlqimit për Miratim të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, i Propozon Kuvendit të Komunës, të Miratoi këtë Propozim-Vendim, dhe të sjell:

VENDIM

Për

Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032

1.Miratohet Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut, për periudhën tetë (8) vjeçare 2024-2032, si një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit, përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe projeksioneve të investimeve publike dhe private, për tërë territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

2.Me Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale, në kontekst të ndryshimeve të bëra me nevojat reale dhe mundësi për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

3.Harta Zonale e Komunës, do të mbuloj sipërfaqen e territorit të Komunës së Mitrovicës së Jugut prej: **S=331.km²** dhe do të përfshi të gjitha Zonat Kadastrale brenda territorit të Komunës.

4.Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Hartës Zonale të Komunës, shfuqizohen të gjitha Planet Rregulluese Urbane si dhe planet tjera të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

5.Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesët: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

6.Ky Vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbdhejtë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë përgjegjëse të Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb faqen Zyrtare të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Nga të theksuarat si më lartë, u propozua për Miratim si në dispozitiv të këtij Propozim- Vendimi.

Në shtojcë:

- Vendimi i MMPHI Nr. Prot.7770-2/22, datë 23.02.2023, për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Vendimi i MMPHI, Nr.prot. 3949-2/24, datë 13.11.2024, për Dhënien e Pëlqimit për Miratim të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032.
- Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-0022696/20- 2, datë 24.04.2020. për Fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, në CD.




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Formulari për procedim të lëndës për nënshkrim:

Përmes këtij formulari, nga personat nënshkrues **Konfirmohet** se, lënda e proceduar për nënshkrim, si Propozim -Vendim, Nr.prot. 02.350/29-00/2778/28 datë 25/03/2025 propozuar Kuvendit të Komunës, për sjellje të Vendimit për Miratim të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, është në përputhje me Vendimin Nr.3949-2/24, datë 13.11.2024 nga MMPHI, për Dhënien e Pëlqimit për Miratim të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032.

Nr.	Personi përgjegjës	Pozita	Nënshkrimi
1.	EDISON TERNAVA	Propozues: Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm Edison Tërnavë - Drejtor	
2.	NEXHMI HASANI	Nexhmi Hasani-Shef i Sektorit për Planifikim	
3.	XHEYDET ARUÇAJ	Zyrtari Ligjor i DPU-së	
4.	Teut Selmani Pllana	Zyra Ligjore	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	13.11.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Edison Tërnavë, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut
CC:	Bedri Hamza, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Afrim Murati UD i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për dhënien e pëlqimit për miratim të "Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032" sipas kërkesës së datës 20.09.2024 dhe Nr. protokolli 3949- 2/24.

I nderuar z. Tërnavë,

Bazuar në kërkesën për miratim të "Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032", e parashtruar nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut, të datës 20.09.2024 dhe Nr. protokolli 3949-2/24, Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke marrë për bazë Vendimin Nr. 22/7770/32/23 datë: 06.02.2023, për Pëlqimin Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Projekt-"Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut" ka shqyrtuar projekt "Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032", sipas Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe vendos sipas vendimit të bashkangjitur në këtë shkresë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar nën 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7,01 Mars 2019), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullore (QRK) Nr. 04/2021, si dhe nën 9 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nxjerrë:

V E N D I M

Për dhënien e pëlqimit për miratim të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032

Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas verifikimit të përputhshmërisë së projekt – "Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032", me "Planin Hapësinor të Kosovës -Strategjinë e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, jep pëlqim për miratim të "Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032".

A r s y e t i m

Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut, me shkresë zyrtare të datës 20.09.2024 dhe Nr. protokoli 3949-2/24, ka kërkuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit pëlqim për miratim të Projekt – Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, sipas procedurës ligjore pas shqyrtimit publik të hapur më datën 06.03.2024 deri më 07.04.2024.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt – "Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032" dhe dokumentacionit përcjellës si



Raporti i Vlerësimit Strategjikë Mjedisor dhe Raporti nga Shqyrtimi Publik, konstaton se ky dokument:

1. I plotëson kushtet ligjore të parapara me Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor mbi procedurat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor;
2. Është në pajtim me nenin 16 dhe 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
3. Është në përputhshmëri me "Planin Hapësinor të Kosovës - Strategjinë e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+";
4. Është në pajtim me Udhëzimin Administrativ MMPH-NR.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.
5. Është në pajtim me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Komuna e Mitrovicës së Jugut brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit të dokumentit të planifikimit hapësinor nga Kuvendi i Komunës duhet të dorëzojë në Departamentin për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës "Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032", me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe kompletimit të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave të planifikimit hapësinor, sipas neni 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

"Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032" duhet të dorëzohet në Departamentin për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit për miratim të Hartës Zonale të Komunës, në kuptim të nenit 81 të Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Komuna e Mitrovicës së Jugut gjatë hartimit të "Hartës Zonale të Komunës" është bazuar në "Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031" dhe dokumentet e tjera të planifikimit hapësinor të komunës në fuqi.

Bazuar në kërkesat e reformës ligjore, objektivat e planeve zhvillimore dhe strategjike të sektorëve të qeverisë dhe të komunës, miratimit të ligjeve që ndikojnë në fushën e zhvillimeve në legjislacion dhe zbatimit të projekteve nga niveli qendror duke përfshirë gjendjen ekzistuese të krijuar në teren në tërësi, në raste të caktuara këto objektiva dhe caqe nuk kanë qenë të mjaftueshme për përcaktimin e saktë të sipërfaqeve dhe masave për të gjithë sektorët.

"Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032" duhet të përkthehet në gjuhën serbe ashtu si parashihet në nenin 5 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIE ZHIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Ajësia nr: Org./Institucia Org./Unit	01-M
Nr i F. qeverie: Br. Seranica No. Pages	- 03 -
Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	7770-2/22
Datim: Datum: Date:	23.02.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrisë / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

DATE/A:	06.02. 2023
REFERENC-Ë:	22/7770/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Komunën e Mitrovicës së Jugut"
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Liburn Aliu, Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka pranuar Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të "Komunës së Mitrovicës së Jugut" 2023-2027 me nr.: 22/7770/766/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të "Komunës së Mitrovicës së Jugut" 2023-2027

Me respekt,

Faqe 1 nga 3

Adresa/ Objekti: Rr. Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" katë 17, nr. 1713 - 10.000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrisë / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Pas shqyrtimit të Raportit për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të "Komunës së Mitrovicës së Jugut" 2023-2027 si dhe marrjes së propozimit nga Komisioni për vlerësimin e raportit të lartëpërmendur, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230, Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerr këtë:

V E N D I M

Komuna e "Mitrovicës së Jugut", pajiset me Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të "Komunës së Mitrovicës së Jugut" 2023-2027

A r s y e t i m

Komunës së Mitrovicës së Jugut, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shqyrtuar kërkesën, dokumentacionin, Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të "Komunës së Mitrovicës së Jugut" 2023-2027, proces verbalin e Debatit Publik për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të "Komunës së Mitrovicës së Jugut" 2023-2027, listën e pjesëmarrësve në Debat Publik.



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës merr vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut" 2023-2027

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padri në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 22/7770/**32**/23 datë: 06.02.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VSM
3. Inspektoratit të MMPHI-së
4. Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivi i MMPHI
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut

Liburn

Ministër i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0022696/20-2 dt. 24.04.2020
Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d, nenit 17, pika b, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); neni 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.2, neni 10, pika 1.2, neni 11, pika 1.3 dhe neni 16 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për planifikimin hapësinor, neni 2 dhe 5 dhe Udhëzimit Administrativ – MMPH Nr. 24/2015 Mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Nr. 6557/15 dt. 30.12.2015, si dhe nenin 23, paragrafi 23.1 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më dt. 24.04.2020 me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01 0020531/20-3 dt. 18.03.2020, sjellë këtë:

VENDIM

Për fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut

1. Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
2. Harta Zonale e Komunës është një dokument shumë sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës për periudhën tetë (8) vjeçare.
3. Me Hartën Zonale të Komunës nga pika 1 e këtij vendimi, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale, në kontekst të ndryshimeve të bëra, dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Mitrovicës së Jugut, si dhe plotësohen kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe rurale.
4. Në zonat kadastrale të territorit të Komunës së Mitrovicës së Jugut konform me Ligjin Nr. 03/L-041 Për kufijtë administrativ të Komunave janë të përfshira këto zona kadastrale:

Nr.	Zona Kadastrale	Shifra	ha	ari	m ²
1.	Bajgorë	71208001	2293	63	21
2.	Bare	71208005	1432	57	46
3.	Batahir	71208007	472	40	59
4.	Broboniq	71208014	1527	37	65
5.	Dedi	71208038	614	14	93
6.	Kaçandoll	71208065	2990	66	42
7.	Këçi i Madh	71202012	799	46	74
8.	Koprivë	71208070	353	15	95
9.	Koshtovë	71208074	1610	22	81
10.	Kovaçicë	71208067	944	44	83

11.	Kutlllove	71208076	450	45	69
12.	Lushtë	71208083	429	57	30
13.	Maxherë	71208129	514	76	98
14.	Mazhiq	71208084	457	79	49
15.	Melenicë	71208088	659	3	87
16.	Mitrovicë	71208072	724	72	86
17.	Ofqar	71208091	424	2	85
18.	Rahovë	71208093	1044	16	67
19.	Rashan	71208099	936	88	40
20.	Rzhanë	71208102	1088	26	84
21.	Selac	71208106	3415	69	28
22.	Shipol	71208127	155	2	87
23.	Shupkove	71208128	1222	93	14
24.	Stantërg	71208112	450	92	96
25.	Stranë	71208113	258	19	88
26.	Suhadoll	71208114	127	46	38
27.	Svinjarë/Frashër	71208105	685	46	58
28.	Tërstenë	71208116	623	11	81
29.	Vaganicë	71208017	543	33	65
30.	Vërbnicë/Vërmicë	71208028	968	59	72
31.	Vidishiq	71208024	1030	48	20
32.	Vidomiriq/Vidimriq	71208023	256	16	60
33.	Vinarc i Ulët	71208042	470	75	59
34.	Vllahi	71208025	1656	78	16
35.	Zabërgj	71208050	563	11	00
36.	Zhabar i Ulët	71208043	292	2	1
37.	Zhabar i Epërm	71208032	264	68	60
38.	Zijaqë	71208054	347	58	48
39.	Vinarc i Epërm	-----	-----	-----	-----
40.	Këciq i Vogël	-----	-----	-----	-----

4.1 Vinarci i Epërm shtrihet në Zonën Kadastrale të Koshtovës, dhe nuk ka shifër as në Regjistër Kadastral të Komunës, as në atë të Agjencionit Kadastral të Kosovës.

4.2 Këciqi i Vogël, shtrihet në Zonën Kadastrale të Shupkovecit, dhe po ashtu nuk ka shifër as në Regjistër Kadastral të Komunës, as në atë të Agjencionit Kadastral të Kosovës.

5. Bartës për hartimin e Planit caktohet Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.
6. Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut.
7. Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës me drejtoritë sektoriale, burimet njerëzore brenda komunës dhe ekipi konsulent mbështetës.
8. Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas pikës 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat prej 18 muaj, që nënkupton kompletimin e dokumentit për prezantim në procesin e konsultimeve publike, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Para finalizimit të projektit për hartimin e Hartës Zonale drafti duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e projektit të Hartës Zonale në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e sugjerimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

10. Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut, hartohet për periudhën kohore tetë (8) vjeçare.
11. Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës, dhe së paku në tri (3) kopje të shtypura e të vulosura dhe tri (3) kopje digjitale të origjinalit.
12. Pjesë e këtij vendimi është Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë sipas nenit 11, pika 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 Për planifikim hapësinor.
13. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI



Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Programi i punës për hartimin dhe menaxhimin e Hartës Zonale, të Komunës së Mitrovicës së Jugut

Për shkak të kërkesave të reja ligjore dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore, përmes konkursit të projektimit Komuna e Mitrovicës së Jugut do të angazhojë kompani profesionale për hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK).

Në vijim janë të radhitura aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës:

1. Punët parapërgatitore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përcaktimi i grupit punues	A. Përcaktimi i udhëheqësit të projektit, koordinatorëve të drejtorive (KD) vijuese: a. Administratë e Përgjithshme b. Bujqësi dhe Zhvillim Rural c. Kulturë, Rini dhe Sport d. Shërbime Publike dhe Infrastrukturë e. Inspeksion f. Shëndetësi g. Arsim h. Financa dhe Zhvillim Ekonomik i. Panifikim dhe Urbanizëm j. Mbrojtje të Mjedisit k. Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë l. Mbrojtje dhe Shpëtim m. Integritet Europian dhe Mirqenie Sociale n. Prokurim	Përcaktimi i grupit punues	1 javë	Kryetari i Komunës
2. Përcaktimi i grupeve të interesit	A. Përcaktimi i grupeve lokale të interesit, Institucione të nivelit Qendror, Organizata të jashtme që ofrojnë shërbime publike, OJQ, Biznese, Përfaqësues të fshatrave dhe bashkësive lokale (GP); B. Krijimi i listës dhe kontakteve të Pjesëmarrësve.	Përcaktimi i grupeve të interesit		Udhëheqësi komunal i projektit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
	pjesëmarrësve.			
3. Trajnimi i punonjësve të Komunës	A. Njoftimi i drejtorive rreth procesit të planifikimit hapësinor dhe HZK-ës nga kompania konsulente/mbështetëse; B. Trajnimi i punonjësve për shfrytëzimit të GIS-it nga kompania hartuese;	Trajnimi i punonjësve të Komunës	2 javë	Kompania konsulente
4. Hartimi i konceptit dhe planit të punës	A. Shqyrtimi i Kornizës Logjike të HZK-ës sipas UA dhe ligjit; B. Identifikimi i Rrezeve/ Kërcënimeve; C. Krijimi i strukturës përmbajtësore të HZK-ës; D. Prezantimi i strukturës së dokumentit dhe konceptit të punës, para drejtorive Komunale.	Hartimi i konceptit dhe planit të punës	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
5. Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët	A. Përgatitja e prezantimit të planit të punës dhe qëllimit të HZK-se për takimin njoftues me banorët dhe GP; B. Takimi njoftues me banorë të zonës urbane dhe GP; C. Katër takime njoftuese me banorë të zonave rurale lindore, jugore, perëndimore dhe veriore.	Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

2. Migrimi dhe konsolidimi i të dhënave të dokumenteve ekzistuese të planifikimit hapësinor

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Migrimi i dhe konsolidimi të dhënave hartografike	A. Migrimi dhe konsolidimi i të dhënave hartografike ekzistuese nga: a. Plani Zhvillimor Urban; b. Planet Rregulluese Urbane;	Para se të fillohet me përgatitjen e HZK-ës, nevojitet që të krijohet baza e të dhënave ekzistuese hartografike.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Konsolidimi i kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore ekzistuese	A. Konsolidimi i kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore ekzistuese nga: a. Plani Zhvillimor Urban; b. Planet Rregulluese Urbane;	Para se të fillohet me përgatitjen e HZK-ës, nevojitet që të krijohet baza e të kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore ekzistuese.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

3. Identifikimi i të dhënave shtesë që duhet të përpunohen

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe përputhshmërisë së kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore ekzistuese me nevojat dhe PZhK-në e miratuar	A. Vlerësimi profesional nga ndërmarrja e kontraktuar; B. Përgatitja e prezantimit dhe raportit vlerësues, duke përfshirë përcaktimin kushteve shtesë që duhet të përgatiten në përputhje me UA për HZK; C. Dorëzimi dhe prezantimi i raportit vlerësues për KD	Vlerësimi i të dhënave ekzistuese dhe identifikimi i të dhënave shtesë që duhet të përpunohen në bazë të kërkesave të UA për HZK	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

4. Përgatitja e kushteve të përgjithshme zhvillimore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e kushteve të përgjithshme zhvillimore dhe hartave	A. Përpilimi e kushteve të përgjithshme zhvillimore, të cilat janë të zbatueshme për tërë territorin dhe shfrytëzimet e përcaktuara në PZhK; B. Përgatitja e prezantimit të kushteve të përgjithshme zhvillimore dhe hartave; C. Dorëzimi dhe prezantimi i raportit vlerësues për KD	Kushtet e përgjithshme zhvillimore duhet të përcaktohen për tërësi territoriale më të gjera që përmbajnë kritere të ngjashme.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

5. Përgatitja e kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e kushteve zhvillimore dhe hartave për zonat e përcaktuara	A. Përpilimi i kushteve zhvillimore, për zonat e caktuara specifike dhe hartat; B. Përgatitja e prezantimit të kushteve zhvillimore dhe hartave; C. Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve	Përgatitja e kushteve zhvillimore dhe hartave për zonat e përcaktuara specifike	3 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
specifike	zhvillimore dhe hartave për KD			
2. Përgatitja e kushteve ndërtimore dhe hartave për zonat e përcaktuara për ndërtim	A. Përpilimi i kushteve ndërtimore, për zonat e përcaktuara për ndërtim; B. Përgatitja e prezantimit të kushteve ndërtimore dhe hartave; C. Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve ndërtimore dhe hartave për zonat e përcaktuara për ndërtim për KD	Përgatitja e kushteve ndërtimore dhe hartave për zonat e përcaktuara për ndërtim	3 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
3. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

6. Përgatitja e zonave mbishtresore dhe kushteve zhvillimore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e zonave mbishtresore, kushteve zhvillimore dhe hartave	A. Përpilimi e zonave mbishtresore, kushteve zhvillimore dhe hartave; B. Përgatitja e prezantimit të zonave mbishtresore, kushteve zhvillimore dhe hartave; C. Dorëzimi i zonave mbishtresore, kushteve zhvillimore dhe hartave për KD	Kushtet zhvillimore duhet të përcaktohen për zona mbishtresore.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

7. Përgatitja e kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e kushteve zhvillimore dhe hartat për infrastrukturë teknike dhe hartave	A. Përpilimi e kushteve zhvillimore dhe hartat për infrastrukturë teknike dhe hartave B. Përgatitja e prezantimit i kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike dhe hartave; C. Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike dhe hartave për KD	Kushtet zhvillimore për infrastrukturë teknike, duhet të përcaktohen për të caktuar zhvillimin e kësaj infrastrukture.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

8. Përgatitja e kushteve zhvillimore për infrastrukturë rrugore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e kushteve zhvillimore dhe hartat për infrastrukturë rrugore dhe hartave	A. Përpilimi e kushteve zhvillimore dhe hartat për infrastrukturë rrugore, profileve dhe hartave; B. Përgatitja e prezantimit i kushteve zhvillimore për infrastrukturë rrugore, profileve dhe hartave; C. Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë rrugore, profileve dhe hartave për KD	Kushtet zhvillimore për infrastrukturë rrugore, duhet të përcaktohen për të caktuar zhvillimin e kësaj infrastrukture.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

9. Përgatitja e kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e hartave dhe kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale	A. Përpilimi i hartave dhe kushteve zhvillimore dhe hartat për infrastrukturë publike dhe sociale; B. Përgatitja e prezantimit të hartave dhe kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale; C. Dorëzimi dhe prezantimi i hartave dhe kushteve zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale për KD	Hartat dhe kushtet zhvillimore për infrastrukturë publike dhe sociale, duhet të përcaktohen për të caktuar zhvillimin e kësaj infrastrukture.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

10. Përgatitja e arsyetimit për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e arsyetimit për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara	A. Përpilimi i arsyetimit për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara dhe hartat; B. Përgatitja e prezantimit arsyetimit për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara; C. Dorëzimi dhe prezantimi i arsyetimit për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara për KD	Për zona specifike me interes të veçantë për Komunën duhet të përgatitet arsyetimi për nevojën e hartimit të planeve rregulluese.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.		Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

11. Prezantimi publik i draft kushteve zhvillimore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
3. Përgatitja e prezantimit publik të kushteve zhvillimore	A. Përpilimi i prezantimit publik të kushteve zhvillimore, duke përfshirë: a. Kushtet e përgjithshme për zhvillim për të gjitha zonat; b. Lista e zonave dhe Lista e zonave mbishtresore; c. Zonat e destinuara dhe kushtet zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore; d. Zonat Mbishtresore dhe Kushtet Zhvillimore; e. Infrastruktura teknike; f. Infrastruktura rrugore; g. Infrastruktura publike dhe sociale; h. Arsyetimi për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara; i. Plani i Veprimit për Zbatim; j. Administrimi, zbatimi dhe monitorimi i zbatimit;	Njoftimi publik rreth zhvillimit të dokumentit është shumë i rëndësishëm.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
	k. Ndryshim plotësimet dhe përjashtimet; B. Dorëzimi dhe prezantimi i arsyetimit për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara për KD			
4. Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve zhvillimore	A. Prezantimi publik për banorë të zonës urbane; B. Prezantimi publik për banorë të zonës rurale lindore; C. Prezantimi publik për banorë të zonës rurale jugore; D. Prezantimi publik për banorë të zonës rurale perëndimore; E. Prezantimi publik për banorë të zonës rurale veriore;	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
5. Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

12. Përgatitja e Planit të Veprimit dhe Zbatimit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e Planit të Veprimit dhe Zbatimit	A. Përpilimi i Planit të Veprimit dhe Zbatimit; B. Përgatitja e prezantimit të Planit të Veprimit dhe Zbatimit; C. Dorëzimi dhe prezantimi i Planit të Veprimit dhe Zbatimit për KD	Për të gjitha investimet kapitale publike, publiko – private dhe private që parashihen në HZK, dihet të përgatitet Plani i Veprimit dhe Zbatimit.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

13. Përgatitja e Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi të Zbatimit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e Planit të Administrimit,	A. Përpilimi i Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi të Zbatimit;	Për të gjitha investimet kapitale publike, publiko – private dhe private që	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
Zbatimit dhe Monitorimi të Zbatimit	B. Përgatitja e prezantimit të Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi të Zbatimit; C. Dorëzimi dhe prezantimi i Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi të Zbatimit për KD	parashihen në HZK, dihet të përgatitet Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi të Zbatimit.		kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

14.Përgatitja e Përgjashtimeve

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e Përgjashtimeve	A. Përpilimi i Përgjashtimeve; B. Përgatitja e prezantimit të Përgjashtimeve; C. Dorëzimi dhe prezantimi i Përgjashtimeve për KD	Për të gjitha investimet kapitale publike, publiko – private dhe private që parashihen në HZK, dihet të përgatitet Planit të Administrimit, Zbatimit dhe Monitorimi të Zbatimit.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga KD.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për HZK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

15.Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së HZK-ës

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së HZK-ës	A. Përfundimi i Kapitujve të: a. Hyrjes; b. Arsytimit; c. Listës së zonave dhe Lista e zonave Mbishtresore; d. Përkufizimeve; e. Pjesës Hartografike; B. Konsolidimi tërë dokumentit	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
2. Dorëzimi i HZK-ës në MMPH për vlerësimin e përmbajtjes para zhvillimit të Shqyrtimit Publik	A. Dorëzimi i draftit përfundimtar të HZK-ës në MMPH; B. Përgatitja e prezantimit të draftit përfundimtar të HZK-ës në MMPH; C. Zhvillimi i prezantimit draftit përfundimtar të HZK-ës në MMPH. D. Miratimi i MMPH-s për iniciimin e	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
	shqyrtimit publik të draftit përfundimtar të HZK-ës në MMPH			

16.Shqyrtimi publik i HZK-ës

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Vendimi për zhvillimin e Shqyrtimit Publik	A. Përgatitja e vendimit për shqyrtimin publik të HZK-ës; B. Njoftimi i banorëve dhe hisedarëve tjerë për zhvillimin e shqyrtimit publik;	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	1 javë	Kryetari i Komunës
2. Zhvillimi i Shqyrtimit Publik	A. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi publik i draftit përfundimtar të HZK-ës; B. Mbajtja e ekspozitës të përmbajtjes së draftit përfundimtar të HZK-ës; C. Pranimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve nga banorëve dhe hisedarë tjerë.	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente
3. Raporti i Shqyrtimit Publik	A. Përgatitja e Raportit të Shqyrtimit Publik	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe zyra pritëse
4. Inkoorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve	A. Ndryshimi i HZK-ës në përputhje me i vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e arsyeshme të dorëzuara	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit dhe kompania konsulente

17.Miratimi i HZK-ës

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Miratimi i HZK-ës nga MMPH	A. Dorëzimi i HZK-ës në MMPH për miratim B. Inkoorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga MMPH, në rast se ka C. Miratimi i HZK-ës nga MMPH	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
2. Miratimi i HZK-ës nga Kuvendi Komunal	A. Dorëzimi i HZK-ës në Kuvend Komunal për miratim B. Inkoorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga Kuvendi Komunal, në rast se ka C. Miratimi i HZK-ës nga Kuvendi Komunal	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të HZK-ës.	1 javë	Kryetari i Komunës